



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs



AGJENCIA E KOSOVËS PËR FORENZIKË

Kosovska Agencija za Forenziku | Kosovo Agency on Forensic

Plani i Përformancës për vitin 2025

2003

Tetor 2024



PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	3
PARATHËNIE	4
HYRJE	5
Misioni	7
1. Përmbledhja e Objektivave.....	7
2. Treguesit matës në arritjen e objektivave.....	9
3. Vlera bazë dhe vlera e synuar	10
4. Outputet	10
5. Aktivitetet	11
6. Alokimi Financiar	13
7. Referenca në dokumente strategjike/politike	14
Shtojca I – Plani i Përformancës.....	15



SHKURTESAT

AKF	-	Agjencia e Kosovës për Forenzikë
DFK	-	Departamenti i Forenzikes Krahastimore
DFTI	-	Departamenti i Forenzikes së Teknologjisë së Informacionit
DFA	-	Departamenti i Forenzikes Analitike
DAP	-	Departamenti për Administrim të Përgjithshëm
UNDP	-	United Nations Development Program
ICMP	-	International Commission for Missing Persons
UNODC	-	United Nations Office on Drugs and Crime
CTS	-	Collaborative Testing Services
ENFSI	-	European Network of Forensic Science Institutes
IBIS	-	Integrated Ballistic Identification System
CODIS	-	Combined DNA Index System
EVOFINDER-	-	Evidence Finder
CABIS	-	Cogent Automated Biometric Identification System
LIMS	-	Laboratory Information Management System
ILECU	-	Zyra Ndërlidhëse për bashkëpunim ndërkombëtar
INTERPOL	-	International Criminal Police Organization
EUROPOL	-	European Union Agency for Law Enforcement Cooperation
TOOLSCAN	-	Skaner i Gjurmëve të veglave
VMD	-	Vacuum Metal Depository



Parathënie

Agjencia e Kosovës për Forenzikë është Agjenci e pavarur ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, e cila funksionon nga viti 2011, me një trashëgimi të pasur nga Policia e Kosovës pjesë e së cilës ka qenë në të kaluarën. AKF-ja është institucioni përgjegjës për ofrimin e paanshëm dhe objektiv të analizave shkencore forenzike, e cila kryen veprimet me urdhër të gjykatës, vendim të prokurorisë, me kërkesë të Policisë së Kosovës dhe agjencive të zbatimit të ligjit.

AKF-ja është mandatuar për kryerjen e ekspertizave forenzike nga fusha e balistikës, gjurmëve të gishtave, gjurmëve traseologjike, dokumenteve, dorëshkrimeve dhe parasë, serologjisë dhe ADN-së, analizave kimike të narkotikëve, zjarrëvënjeve, eksplozivëve dhe grimcave të barotit, ekzaminimeve të kompjuterëve, ekzaminimeve multimediale, ekzaminimeve financiare, etj.

Agjencia e Kosovës për Forenzikë, po ashtu posedon edhe dhomën e ruajtjes së provave në pajtueshmëri me praktikat më të mira të normave kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu AKF-ja administron me pesë sisteme të rëndësishme shtetërore: CABIS, LIMS, CODIS, EVOFINDER dhe IBIS.

AKF bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë themelore të saj të përcaktuara në ligjin nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë e ka përgatitur Planin e performances për vitin 2025 në përputhje me “Strategjinë zhvillimore 2022-2026 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë”, Planin e Veprimit si dhe bazuar në kriteret e përcaktuara në Rregulloren (QRK) nr.12/2023 mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore.



Hyrje

Agjencia e Kosovës për Forenzikë•ka hartuar Planin e performances 2025 duke u bazuar në Rregulloren (QRK) nr.12/2023 mbi Sistemin e Menaxhimit të Performances për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore e cila buron nga Ligjin nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.

Plani i Performances 2025 ndërlidhet me objektivat e përcaktuara në “Strategjinë zhvillimore 2022-2026 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë dhe Planin e veprimit”.

Me qëllim të ngritjes së performances të AKF-së janë planifikuar katër objektiva kryesor të cilët janë të domosdoshëm dhe që janë hartuar sipas kërkesave ligjore në Ligjin nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura si dhe Rregulloren (QRK) nr. 12/2023 mbi Sistemin e Menaxhimit të Performances për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore.

Aktivitetet për përmbushjen e objektivave të planit të veprimit përfshinë gjithë strukturën organizative të agjencisë duke filluar nga:


- Drejtori Ekzekutiv,
- Departament i Forenzikes Krahasmorre,
- Departamenti i Forenzikes Analitike,
- Departamenti i Forenzikes të Teknologjisë së Informacionit dhe
- Departamenti për Administrimin e Përgjithshëm.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në AKF është 55.

Për realizimin e Planit të Performances 2025, AKF mund të sfidohet nga faktorët e brendshëm dhe të jashtëm. Si sfidë e brendshme është mungesa e buxhetit dhe burimeve njerëzore si pasojë e ngarkesës në punë dhe rritjes në vazhdimësi të numrit të rasteve, realizimit të projektit për renovimin e objektit të vjetër të AKF-së, buxhetit të pamjaftueshëm, implementimin e projekteve dhe avancimit të teknologjisë në përputhje me sfidat që dalin si rrjedhojë e zhvillimit të teknologjisë, dhe për funksionalizimin e fushave të reja forenzike.



Sfidë e jashtme është mungesa e shërbimeve të specializuara dhe furnizimeve që ofrohen nga kompanitë e jashtme kontraktuese si dhe kostoja e lartë që AKF duhet të paguaj për marrjen e këtyre shërbimeve, furnizimeve për shkak të tregut të vogël dhe natyrës specifike të shërbimeve dhe furnizimeve që kërkohen për të operuar.



Misioni

Agjencia e Kosovës për Forenzikë do të vazhdojë misionin e saj për kryerje të shërbimeve forenzike në mënyrë të pavarur, të paanshme, objektive dhe në përputhje me standardet vendore dhe ndërkombëtare të cilësisë dhe sigurisë.

1. Përmbledhja e Objektivave

Objektivat e përcaktuara për vitin 2025 për AKF-në:

Menaxhmenti i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, ka mbajtur një seri takimesh pune ku të gjitha departamentet dhe divizionet kanë shqyrtuar kërkesat ligjore dhe kanë raportuar për përmbushjen e Planit Vjetor të Punës për vitin 2024. Gjithashtu kanë identifikuar objektivat dhe aktivitetet që do kontribuojnë në zbatimin e objektivave të identifikuara për vitin 2025.

Plani i performancës i Agjencisë të Kosovës për Forenzikë është i organizuar në katër objektiva si në vijim:

1. kryerja e ekspertizave forenzike;
2. furnizimi me pajisje, aparaturë dhe teknologji bashkëkohore;
3. krijimi i kapaciteteve të reja forenzike dhe zhvillimi i burimeve njerëzore;
4. akreditimi dhe zgjerimi i fushës së akreditimit me metoda të reja shkencore forenzike;

Agjencia e Kosovës për Forenzikë në kuadër të mandatit për realizimin e objektivave ka planin e punës që përmban shtatëmbëdhjetë (17) aktivitete gjegjëse. Secili aktivitet ka titullin, përshkrimin e shkurtër të aktivitetit, njësinë përgjegjëse për zbatim, afatin kohor të zbatimit, duke përfshirë edhe periodhat kur do të raportohet, treguesit e performancës dhe një vlerësim të përafërt të kostos dhe burimit të financimit.

Agjencia e Kosovës për Forenzikë ka për mision ofrimin e shërbimeve forenzike në mënyrë të pavarur, të paanshme, objektive dhe në përputhje me standardet vendore dhe ndërkombëtare të cilësisë dhe sigurisë. Duke i aplikuar këto standarde, AKF-ja ofron dhe garanton saktësi, objektivitet dhe besueshmëri për shërbimet e ofruara për institucionet e sigurisë dhe drejtësisë në Republikën e Kosovës.



Agjencia e Kosovës për Forenzikë ka rritur hapësirat e punës duke krijuar kushte më të mira, të përshtatshme dhe optimale për divizionet ekzistues, si dhe për divizionet që do të funksionalizohen gjatë viteve në vijim. Furnizimi me pajisje, aparaturë dhe teknologji bashkëkohore është i domosdoshëm për të qenë në trend me zhvillimet teknologjike në nivel botëror si dhe për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe në kohë për palët. Përditësimi i pajisjeve, aparaturës, licencave softuerike dhe teknologjisë rrjedh edhe nga fakti i vjetërsimit të tyre, amortizimit për shkak të përdorimit si dhe pamundësisë për të siguruar shërbime të mirëmbajtjes nga prodhuesit apo servisesit e autorizuar. Disa nga pajisjet e planifikuara do të shërbejnë edhe për të rritur numrin e shërbimeve që AKF-ja i ofron për palët.

Agjencia e Kosovës për Forenzikë parasheh krijimin e dy divizioneve të reja, që kanë të bëjnë me ekspertizën financiare dhe gjurmët traseologjike, funksionalizimin e plotë të divizionit për analizë të zjarrevënjeve, eksploziveve dhe grimcave të barotit, si dhe ofrimin e shërbimeve të analizave kuantitative të substancave narkotike.

Zhvillimi i burimeve njerëzore në AKF-e do bëhet përmes mbajtjes së trajnimeve, kryerjen e testeve të aftësive profesionale, pjesëmarrjen në testet grupore, angazhimin e punonjësve në vizita studimore dhe pjesëmarrja në konferenca forenzike.

Akreditimi është me së i nevojshëm për të garantuar cilësinë e shërbimeve forenzike dhe rritjen e besimit të palët. AKF-ja ka obligim ligjor akreditimin e metodave të punës për të gjitha fushat e ekspertizave forenzike dhe zgjerimin e fushave me metodat e reja shkencore forenzike të cilat duhet akredituar..

Agjencia e Kosovës për Forenzikë në vitin 2025 parashihet të përkrahet nga dy projekte:

- a) projekti i UNDP për ngritjen e kapaciteteve të institucioneve ligj zbatuese në kuadër të udhërrëfyesit për zvogëlimin e numrit të armeve, municioneve dhe eksploziveve 2024-2026 dhe
- b) projektit i ICMP (International Commission for Missing Persons) për ngritjen e kapaciteteve në Divizionin e Serologjisë dhe ADN-se për identifikimin e personave të zhdukur.



2. Treguesit matës në arritjen e objektivave

Objektivi 1: Kryerja e ekspertizave forenzike

Për realizmin e këtij objektivi hartohet plani dinamik i punës për numrin e ekspertizave që planifikohet të realizohet në vitin 2025 i ndarë nëpër të gjitha divizionet gjegjëse. Ky plan do të rishikohet vazhdimisht gjatë vitit për të arritur realizmin e tij. Vlerësimi i realizimit të përmbushjes së këtij objektivi do të bëhet me treguesin e shprehur në përqindje.

Objektivi 2: Furnizimi me pajisje, aparaturë dhe teknologji bashkëkohore

Për të ndjekur zhvillimet bashkëkohore të zhvillimit të shkencës së forenzikës dhe ofrimit të shërbimeve me kualitative për palët është e nevojshme përditësimi i pajisjeve, licencave, softuerëve, etj. Për realizmin e këtij objektivi është bërë plani preliminar i prokurimit publik i cili është përcjell në Ministrinë e Punëve të Brendshme brenda kufirit buxhetor të përcaktuar paraprakisht për këtë kategori. Vlerësimi i realizimit të përmbushjes së këtij objektivi do të bëhet me treguesin e shprehur në përqindje.

Objektivi 3: Krijimi i kapaciteteve të reja forenzike dhe zhvillimi i burimeve njerëzore

Zhvillimi i hovshëm i shkencës së Forenzikës dhe kërkesa nga palët për shërbime shtesë ka ndikuar që ne të rrisim kapacitetet njerëzore përmes trajnimeve profesionale në mënyrë që tu ofrojmë këto shërbime palëve. Për realizmin e këtij objektivi është draftuar rregullorja e re për organizimin e brendshëm që ka paraparë sistematizimin e Personelit të AKF-së, krijimin e divizioneve të reja dhe zgjerimin e fushave të ekspertizës. Vlerësimi i realizimit të përmbushjes së këtij objektivi do të bëhet me treguesin e shprehur në përqindje.

Objektivi 4: Akreditimi dhe zgjerimi i fushës së akreditimit me metoda të reja shkencore forenzike

Këtij objektivi Agjencia e Kosovës për Forenzikë i kushton rendësi të veçantë për tu dëshmuar palëve se metodat shkencore të punës dhe rezultatet e fituara janë konform standardeve ndërkombëtare



dhe të krahasueshme me Laboratorët tjerë ndërkombëtar. Për realizimin e këtij objektivi AKF ka kontratë për marrjen e shërbimeve të vlerësimit /auditimit të jashtëm për akreditimin dhe mirëmbajtjen e metodave dhe po ashtu jemi në proces të përgatitjes së metodave të reja për akreditim. Vlerësimi i realizimit të përmbushjes së këtij objektivi do të bëhet me treguesin e shprehur në përqindje.

3. Vlera bazë dhe vlera e synuar

Objektivi 1: Kryerja e ekspertizave forenzike

- Vlera bazë parashihet të jetë 93%
- Vlera e synuar parashihet të jetë 96%

Objektivi 2: Furnizimi me pajisje, aparaturë dhe teknologji bashkëkohore

- Vlera bazë parashihet të jetë 49%
- Vlera e synuar parashihet të jetë 91%

Objektivi 3: Krijimi i kapaciteteve të reja forenzike dhe zhvillimi i burimeve njerëzore

- Vlera bazë parashihet të jetë 49%
- Vlera e synuar parashihet të jetë 76%

Objektivi 4: Akreditimi dhe zgjerimi i fushës së akreditimit me metoda të reja shkencore forenzike

- Vlera bazë parashihet të jetë 60%
- Vlera e synuar parashihet të jetë 80%

4. Outputet

Për të përmbushur objektivat dhe aktivitetet kryesore në Planin e Performances 2025 është hartuar dhe miratuar Plani i integritetit, Lista e rreziqeve dhe Plani i nevojave të trajnimit. Janë hartuar disa projekte të cilat u janë ofruar donatorëve që kanë shprehur zotimin për mbështetje në trajnime dhe pajisje forenzike. Po ashtu përmes Njësisë përgjegjëse të Ministrisë së Punëve të Brendshme do të investohet në furnizimin me pajisje të Teknologjisë informative. Të gjitha këto aktivitete janë në përputhje me arritjen e përmbushjes së objektivave të përcaktuara.



Përmes realizimit të zgjerimit të fushave të reja forenzike do të ofrohen shërbime të reja në fushat e ekspertizave financiare, ekspertizave të gjurmëve traseologjike etj. Gjithashtu do të realizohen edhe furnizime me material shpenzues laboratorik për kryerjen e ekspertizave forenzike dhe pajisje me licenca dhe programe të avancuara për ekzaminime të forenzike digjitale.

5. Aktivitetet

Objektivi 1. Kryerja e ekspertizave forenzike

Për realizimin e këtij Objektivi planifikohen që të realizohen këto aktivitete:

- Ekspertimi i provave nga DFK, DFTI dhe DFA
- Dëshmimi në gjykatë dhe prokurori i eksperteve të DFK, DFTI dhe DFA
- Pjesëmarrja në ri konstruimin e vendit të ngjarjes prej eksperteve të DFK
- Realizimi i Kërkesave nga palët e treta (ILECU, INTERPOL, EUROPOL, Shtetet individuale, etj.)

Aktivitet e mësipërme do të realizohen përgjatë tërë vitit dhe janë përgjegjësi e të gjitha departamenteve. Bartës i realizimit të këtij Objektivi është Zyra e Drejtorit ekzekutiv.

Objektivi 2: Furnizimi me pajisje, aparaturë dhe teknologji bashkëkohore

Për realizimin e këtij Objektivi planifikohen që të realizohen këto aktivitete:

- Ripërtëritja e licencave të programeve aktuale forenzike për dy divizionet e DFTI.
 - Blerja e mikroskopëve për nevoja të Divizionit të Dokumenteve, Dorëshkrimeve dhe Parasë
 - Blerja e pajisjes VMD për gjurmët e gishtave.
 - Blerja e pajisjes Toolscan për gjurmët traseologjike.
-
- Aktiviteti i parë sipas planifikimit do të realizohet në tremujorin e parë TM1 dhe përgjegjës për zbatimin e këtij aktiviteti do të jetë DFTI.
 - Aktiviteti i dytë sipas planifikimit do të realizohet në tremujorin e parë TM1 dhe përgjegjës për zbatimin e këtij aktiviteti do të jetë DFK.
 - Aktiviteti i tretë sipas planifikimit do të realizohet në TM1-TM2 dhe përgjegjës për zbatimin



e këtij aktiviteti do të jetë AKF dhe UNDP si donatorë.

- Aktiviteti i katërt sipas planifikimit do të realizohet në TM1-TM2 dhe përgjegjës për zbatimin e këtij aktiviteti do të jetë AKF dhe UNDP si donatorë.

Objektivi 3: Krijimi i kapaciteteve të reja forenzike dhe zhvillimi i burimeve njerëzore

Për realizimin e këtij Objekti planifikohen që të realizohen këto aktivitete:

- Certifikimi i ekspertëve për kryerjen e ekspertizës Serologjike dhe të ADN-së.
 - Kryerja e trajnimeve të specializuara nga fusha e ekspertizës financiare për punonjësit e Divizionit për ekspertizë financiare.
 - Kryerja e testeve të aftësive profesionale dhe grupore, vizitat studimore dhe pjesëmarrja në konferenca shkencore.
 - Pjesëmarrja në grupet punuese të ENFSI për Divizionin e Dokumentëve, Dorëshkrimeve dhe Parasë, Divizionin e Forenzikes Multimediale, Divizionin për Ekspertizë të Narkotikëve dhe Koordinatorin për Cilësi.
 - Trajnimi i eksperteve për standardin ISO:17020.
- Aktiviteti i parë sipas planifikimit do të realizohet në tremujorin e parë TM1 dhe përgjegjës për zbatimin e këtij aktiviteti do të jetë DFA dhe Zyrtari i Burimeve Njerëzore.
 - Aktiviteti i dytë sipas planifikimit do të realizohet gjatë tërë vitit (TM1-TM4) dhe përgjegjës për zbatimin e këtij aktiviteti do të jetë Divizionit për ekspertizë financiare dhe Zyrtari i Burimeve Njerëzore
 - Aktiviteti i tretë sipas planifikimit do të realizohet gjatë tërë vitit (TM1-TM4) dhe përgjegjës për zbatimin e këtij aktiviteti do të jetë DAP.
 - Aktiviteti i katërt sipas planifikimit do të realizohet gjatë tërë vitit (TM1-TM4) dhe përgjegjës për zbatimin e këtij aktiviteti do të jetë DAP, DFK, DFA dhe DFTI.
 - Aktiviteti i pestë sipas planifikimit do të realizohet gjatë tremujorit të dytë dhe tretë (TM2-TM3) dhe përgjegjës për zbatimin e këtij aktiviteti do të jetë DAP.



Objektivi 4: Akreditimi dhe zgjerimi i fushës së akreditimit me metoda të reja shkencore forenzike

Për realizimin e këtij Objektivi planifikohen që të realizohen këto aktivitete:

- Angazhimi i eksperteve ndërkombëtar kompetent për akreditimin e dy metodave shkencore forenzike të divizioni i forenzikes multimediale.
 - Angazhimi i eksperteve ndërkombëtar kompetent për mbikëqyrje të metodave shkencore forenzike të akredituara sipas standardit ndërkombëtar ISO:17025/2017.
 - Përgatitja e metodave shkencore për rekonstruimin e të shtënave dhe ekzaminimin e numrave identifikues të automjeteve për akreditim sipas standardit ISO: 17020.
 - Validimi dhe akreditimi i metodës për restaurimin e numrave serik sipas standardit ndërkombëtar ISO:17025/2017.
- Aktiviteteti i parë sipas planifikimit do të realizohet gjatë tërë vitit (TM1-TM4) dhe përgjegjës për zbatimin e këtij aktiviteti do të jetë DFTI dhe DAP.
 - Aktiviteteti i dytë sipas planifikimit do të realizohet gjatë tërë vitit (TM1-TM4) dhe përgjegjës për zbatimin e këtij aktiviteti do të jetë DFTI, DFK, DFA dhe DAP.
 - Aktiviteteti i tretë sipas planifikimit do të realizohet gjatë tremujorit të tretë dhe katër (TM3-TM4) dhe përgjegjës për zbatimin e këtij aktiviteti do të jetë DFK.
 - Aktiviteteti i katër sipas planifikimit do të realizohet gjatë tërë vitit (TM1-TM4) dhe përgjegjës për zbatimin e këtij aktiviteti do të jetë DFK dhe DAP.

6. Alokimi financiar

Për realizimin e të gjitha aktiviteteve nga katër objektivat kostoja financiare administrative dhe e buxhetuar hyn në kategorinë e kostove të kategoritë ekonomike: Paga dhe shtesa, Mallra dhe shërbime, Shpenzime komunale, si dhe projekte kapitale dhe te cilat janë planifikuar në vlerën prej 2,048,551.00€. Duhet të theksohet së disa nga aktivitetet kanë kosto financiare për të cilat kemi zotime së do të mbështeten nga donatorët.

Me UNDP planifikohet të realizohen dy projekte me bashkëfinancim ndërsa nga ICPM do të funksionalizohet njësia për identifikimin e personave të zhdukur në kuadër të Divizionit për ekspertiza serologjike dhe të ADN-së.



7. Referenca në dokumente strategjike/politike

Plani i Performances për vitin 2025 është hartuar duke u mbështetur në Strategjinë zhvillimore të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë 2022-2026, e cila si proces ka qenë e mbikëqyrur dhe e përkrahur nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe është në harmoni me Planin e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 dhe Planin e Punës dhe objektivat strategjike të Ministrisë së Punëve të Brendshme.



Shtojca 1. Plani i Performancës

Objektivat	Treguesi(t)	Vlera bazë	Vlera e synuar	Rezultatet (outputet)	Alokimi financiar	Referenca ndaj dokumenteve strategjike/politike
1. Kryerja e ekspertizave forenzike	Ekspertimi i provave PO	75%	85%	Ekspertimi i provave nga DFK, DFTI dhe DFA	Kosto administrative	Strategjia zhvillimore e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë 2022-2026
	Dëshmimi në Gjykatë dhe Prokurori PO	100%	100%	Dëshmimi në gjykatë dhe prokurori i eksperteve të DFK, DFTI dhe DFA	Kosto administrative	Strategjia zhvillimore e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë 2022-2026
	Rikonstruimi i Vendit të Ngjarjes PO	100%	100%	Pjesëmarrja në rikonstruimin e vendit të ngjarjes i eksperteve të DFK	Kosto administrative	Strategjia zhvillimore e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë 2022-2026
	Kërkimet në sistemet nacionale Forenzike IBIS, CABIS, Evofinder, CODIS, etj. PO	100%	100%	Realizimi i Kërkesave nga palët e treta (ILECU, INTERPOL, EUROPOL, shtetet individuale, etj)	Kosto administrative	Strategjia zhvillimore e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë 2022-2026
	Ripërtëritja e licencave për DFTI PO	46%	90%	Ripërtëritja e licencave të programeve aktuale forenzike për dy divizionet e DFTI me qëllim të përditësimit të programeve për kryerjen e ekspertimeve forenzike.	E buxhetuar	Strategjia zhvillimore e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë 2022-2026
2. Furnizimi me pajisje, aparaturë dhe teknologji bashkëkohore	Blerja e mikroskopëve për nevojat të Divizionit të Dokumenteve dhe Dorëshkrimeve PO	50%	75%	Rritja e kapaciteteve dhe efikasitetit gjatë ekspertimit të rasteve të dokumenteve të dyshuara, dorëshkrimeve, bankënotave dhe kartëmonedhave.	E buxhetuar	Strategjia zhvillimore e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë 2022-2026



3. Krijimi i kapaciteteve te reja forenzike dhe zhvillimi i burimeve njerëzore	Blerja e pajisjes VMD për gjurmët e gishtave. PO	50%	100%	Rritja e kapaciteteve dhe efikasitetit dhe zhvillimi i metodave të reja për nxitjen dhe ekspertimin gjurmëve të gishtave.	E buxhetuar dhe donacion nga UNDP.	Strategjia zhvillimore e Agjencisë së Kosovës për Forenzike 2022-2026
	Blerja e pajisjes Toolscan për gjurmët traseologjike PO	50%	100%	Rritja e kapaciteteve dhe efikasitetit dhe zhvillimi i metodave të reja për gjurmët traseologjike.	E buxhetuar dhe donacion nga UNDP.	Strategjia zhvillimore e Agjencisë së Kosovës për Forenzike 2022-2026
	Certifikimi i ekspertëve për kryerjen e ekspertizës Serologjike dhe të ADN-së PO	70%	100%	Tre punonjësit të cilët janë në proces të trajnimit të certifikuar.	E buxhetuar	Strategjia zhvillimore e Agjencisë së Kosovës për Forenzike 2022-2026
	Trajnime të specializuara PO	40%	80%	Kryerja e trajnimeve të specializuara për punonjësit e DFK	E buxhetuar	Strategjia zhvillimore e Agjencisë së Kosovës për Forenzike 2022-2026
	Zhvillimet profesionale PO	60%	80%	Kryerja e testeve të aftësive profesionale dhe grupore, vizitat studimore dhe pjesëmarrja në konferenca shkencore	E buxhetuar dhe donacione	Strategjia zhvillimore e Agjencisë së Kosovës për Forenzike 2022-2026
	Pjesëmarrja ne ENFSI PO	28%	40%	Pjesëmarrja në grupet punuese të ENFSI për Divizionin e Dokumenteve, Dorëshkrimeve dhe Parasë, Divizionin e Forenzikës Multimediale, Divizionin për Ekspertizë Narkotike dhe Koordinatorin për Cilësi	E buxhetuar	Strategjia zhvillimore e Agjencisë së Kosovës për Forenzike 2022-2026
	Trajnimi i ekspertëve për standardin ISO:17020 PO	50%	80%	Trajnimi i ekspertëve të balistikës dhe gjurmëve traseologjike	Donacion nga SEESAC	Strategjia zhvillimore e Agjencisë së Kosovës për Forenzike 2022-2026



4. Akreditimi dhe zgjerimi i fushës së akreditimit me metoda të reja shkencore forenzike	Akreditimi i metodave të punës të DFTI PO	50%	80%	Angazhimi i eksperteve ndërkombëtar kompetent për akreditimin e dy metodave shkencore forenzike të divizionit i forenzikës multimediale	Donacion nga OSBE	Strategjia zhvillimore e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë 2022-2026
	Mbikëqyrja e akreditimit PO	90%	100%	Angazhimi i eksperteve ndërkombëtar kompetent për mbikëqyrje të metodave shkencore forenzike të akredituara sipas standardit ndërkombëtar ISO:17025/2017	E buxhetuar	Strategjia zhvillimore e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë 2022-2026
	Përgatitja e metodave shkencore për rekonstruimin e të shënave dhe ekzaminimin e numrave identifikues të automjeteve për akreditim sipas standardit ISO: 17020 PO	50%	70%	Hartimi i procedurave, hartimi i planit të validimit, validimi i metodave dhe aplikim të metodave për rekonstruimin e të shënave dhe ekzaminimin e numrave identifikues të automjeteve sipas kërkesave të standardit.	E buxhetuar	Strategjia zhvillimore e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë 2022-2026
	Validimi dhe akreditimi i metodës për restaurimin e numrave serik. PO	50%	80%	Metoda për restaurimin e numrave serik e validuar dhe e akredituar.	E buxhetuar	Strategjia zhvillimore e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë 2022-2026.

[Signature] Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë

